



I. Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm

Motorrik

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik është një bazë e plotë të dhënash për sigurimet e detyrueshme motorrike në vend (TPL e brendshme, karton jeshil, dhe policë kufitare), përfshirë policat e shitura dhe historikun e dëmeve.

Vijon në faqen 2

II. Vështrim mbi tregun e sigurimeve Janar – Nëntor 2007

Në periudhën Janar – Nëntor 2007, primet e shkruara bruto kapën vlerën prej 5,438,586 mijë lekë, perkundrejt 3,968,153 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2006.

Vijon në faqen 5

III. Takimi vjetor i IOPS, Forumi Global mbi Pensionet Private OECD/IOPS

Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD) dhe Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS¹), në bashkëpunim me Komisionin Rregullator të Sigurimeve të Kinës, zhvilluan në Pekin, Kinë gjatë periudhës 13-15 Nëntor 2007, takimet e mëposhtme ...

Vijon në faqen 6

IV. Ngjarje dhe zhvillime të tjera:

IV/1. Baza e të Dhënave të Ligjeve të Sigurimeve (IAIS)

Baza e të Dhënave të Ligjeve të Sigurimeve të IAIS-it ka për qëllim dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis anëtarëve të IAIS-it në mënyrë elektronike. Ajo mbledh të dhëna të plota të ligjeve të sigurimit, rregulloreve dhe praktikave të përdorura nga juridiksione anëtarë të IAIS-it.

Vijon në faqen 8

IV/2. Konferenca “Sfidat kryesore të mbikëqyrjes dhe Bursat në Europën qendrore, lindore dhe juglindore”

Autoriteti Tregut Financiar Austriak (FMA) dhe Bursa e Vienës zhvilluan në Vienë, Austri më 29-30 Nëntor 2007 një konferencë mbi “Sfidat kryesore të mbikëqyrjes dhe Bursat në Europën qendrore, lindore dhe juglindore”.

Gjatë kësaj konference u trajtuan çështje të rëndësishme lidhur me mbikëqyrjen e letrave me vlerë sipas direktivës së instrumentave financiarë dhe drejtimit e përbashkëta të mbikëqyrjes.

Vijon në faqen 10

V. Parimet e IAIS

Parimet Themelore të Sigurimeve të IAIS (Tetor 2000) e përshkruajnë mjaftueshmërinë e kapitalit, midis të tjerave, si një fushë që duhet të gjejë vend në legjislacionet dhe rregulloret e hartuara nga Autoritetet Mbikëqyrëse të Sigurimeve apo institucionet e tjera kompetente në çdo juridiksion.

Vijon në faqen 11

Në këtë numër:

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik

1

Vështrim mbi tregun e sigurimeve Janar - Nëntor 2007

2

Takimi vjetor i IOPS, Forumi Global mbi Pensionet Private OECD/IOPS

3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

4

Parimet e IAIS

5

¹ The International Organization of Pension Supervisors

Çfarë është Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik

Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik është një bazë e plotë të dhënash për sigurimet e detyrueshme motorrike në vend (TPL e brendshme, karton jeshil, dhe policë kufitare), përfshirë policat e shitura dhe historikun e dëmeve.

Furnizimi i Qendrës me të dhëna mundësohet përmes regjistrimit online në kohë reale të policave të shitura nga shoqëritë e sigurimit, si dhe regjistrimit online të të dhënave për dëmet.

Objektivat

- Të përmirësojë mbikëqyrjen e tregut të sigurimeve të detyrueshme motorrike;
- Të shmangë abuzimet;
- Të ndihmojë në aplikimin e sakte të tarifave;
- Të zgjerojë tregun dhe të ulë në maksimum numrin e automjeteve të pasiguruara;
- Të shmangë konkurrencën e pandershme;
- Të mundësojë ndërveprimin mes shoqërive të sigurimit për trajtimin e dëmeve;
- Të rrisë besimin e publikut në sigurimet e detyrueshme motorrike.

Avantazhet

Për shtetin

- Shmangia e abuzimeve përmes emetimit të policave fallco, të paraportuara, apo me ndryshim kategorie;

- Rritja e nivelit të të ardhurave të mbledhura përmes evidentimit të saktë të policave të shitura dhe aplikimit të tarifave korrekte;
- Mbikëqyrja më e mirë e sektorit dhe rritja e nivelit të mbrojtjes së konsumatoreve.

Për shoqëritë e sigurimit

- Eliminimi i konkurrencës së pandershme;
- Rritja e nivelit të të ardhurave;
- Shmangie e abuzimit nga agjentet apo të siguruarit;
- Krijimi i kushteve për sistemin bonus-malus².

Për qytetarët

- Shmangie të mashtrimit ndaj qytetarëve përmes shitjes së policave fallco apo të paregullta;
- Përmirësim të procesit të trajtimit të dëmeve në sigurimet e detyrueshme motorrike.

Data e fillimit të funksionimit

Data e fillimit të funksionimit për Qendrën Kombëtare të të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik është data 10 Nëntor 2007. Megjithatë, për të asimiluar të gjithë problemet teknike të ardhura si pasojë e integritit të sistemeve aktuale të shitjeve të kompanive të sigurimit periudha 10 Nëntor – 1 Dhjetor është konsideruar si periudhë tranzitore. Policat e shitura pas datës 1 Dhjetor 2007, të cilat nuk e kanë marrë numrin e raportimit të gjeneruar nga Qendra Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik do të konsiderohen si shkelje.

² **Bonus-Malus** është një algoritëm i cili aplikon një shtesë ose një zbritje në prim bazuar mbi historikun e dëmeve dhe rinovimeve të policëmbajtësit

Detaje teknike për implementimin total të Qendrës Kombëtare e të Dhënave të Sigurimit të Detyrueshëm Motorrik.

Projekti është menduar të kalojë në tre faza të cilat do të jenë si vijon:

Faza 1

Krijimi i Rregjistrit të Shitjeve Online të Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike

Rregjistri Online i Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike përfaqëson një platformë raportimi dhe identifikimi të shitjeve të policave të sigurimit të detyrueshëm motorrik, përgjegjësi ndaj palëve të treta (MTPL e Brendshme, Kartoni Jeshil, Sigurimi Kufitar). Shkasë për ngritjen e një platformë të tillë kanë qënë së pari shqetësimet e ardhura nga vetë industria, si abuzimet me kategoritë dhe primet, si dhe nevoja për të pasur të centralizuar në një pikë të vetme tërë informacionin e mundshëm për këto portofole.


Ky Rregjistër do të plotësojë dhe përmirësojë kërkesat e AMF për raportim, si dhe nevojat e tregut për një proces më të sigurtë, më të formalizuar dhe më të përshtatshëm të shitjes së policave. Në aspektin afatgjatë Rregjistri do të plotësohet me të dhëna për dëmet në sigurimet e detyrueshme motorrike si dhe do të sigurohen lidhje online me bazat e të dhënave të aksidenteve, identifikimit të personave dhe të mjeteve, përkatësisht me Ministrinë e Brendshme dhe atë të Transportit. Platforma të ngjashme mund të përmendim TRAMER në Turqi nga e cila ky projekt ka trashëguar mjaft karakteristika.

Në rregjistrin e sigurimeve do të rregjistrohen detaje të policave të sigurimeve të detyrueshme motorrike të lëshuara nga shoqëritë e sigurimeve.

Pjesë e procesit është dhe lëshimi i një numri unik, në kohë reale, nga serveri qendror ku mbahet rregjistri për çdo policë të shitur. Numri unik do të realizojë identifikimin e policave duke mundësuar kështu dhe shmangien e abuzimeve me natyrë falsifikuese ose mosraportimi të policave.

Në një fazë të mëvonëshme, me krijimin e kushteve që garantojnë siguri dhe besueshmëri mes shoqërive në treg, ky rregjistër do të zhvendoset jashtë AMF dhe do të jetë nën kujdesin apo manaxhimin direkt të industrisë.

Rregjistri Elektronik Online i Shitjeve të Sigurimeve të Detyrueshme Motorrike



Avantazhet e Rregjistrit të Sigurimeve

Përfituesi kryesor i një zhvillimi të tillë është konsumatori. Rregjistrat aktual të shoqërive të sigurimit përfaqësojnë një informacion të hollësishëm por ende jo tërësisht të standardizuar. Ruajtja e një informacioni më të detajuar, më të plotë dhe më të standartizuar do të ndihmonte në zhvillimin e një historiku të sigurimeve për çdo policëmbajtës si dhe do të evidentonte më së qarti nevojën dhe njohuritë e popullatës për shmangien e rreziqeve financiare me të cilat përballen çdo ditë.

Avantazhet për policëmbajtësit


- Ruajtjen e historikut të tyre në vite dhe në kompani, ku do të përfshihen dhe dëmet;
- Transparencë dhe siguri më të madhe mbi rreziqet e siguruar;
- Lehtësi në marrjen në sigurim;
- Përfaqje drejt një sistemi Bonus-Malus.

Avantazhet për Institucionet Financiare që ushtrojnë aktivitet në Tregun e Sigurimeve

- Praktika të standartizuara të marrjes në sigurim;
- Shkëmbim informacioni të kontrolluar;
- Shmangie të abuzimeve;
- Ulje të numrit të të pasiguarve.

Komunikimi me Rregjistrat e Institucioneve të Tjera


- Të dhënat e shitjeve në mënyrë automatike (jo në kohë reale për momentin) krahasohen në AMF me të dhënat nga DPSHTR për saktësinë e targave dhe fuqive motorrike me qëllim shmangien e abuzimeve;
- Në një të ardhme AMF do të shqyrtojë mundësinë e lidhjes online dhe në kohë reale me ente të tjera shtetërore në mënyrë që të minimizojë sa më shumë abuzimet e mundshme me qëllim një shërbim më cilësor dhe më korrekt ndaj konsumatorit.



Faza 2

Rregjistri i Dëmeve dhe Manaxhimi i Sistemit


AMF në përfundim të implementimit të plotë të Rregjistrat Online në bashkëpunim me shoqëritë synon për ngritjen e rregjistrat të dëmeve në sigurimet e detyrueshme motorrike, i cili në plan afatshkurtër do të rriste transparencën dhe shërbimin ndaj klientit dhe në plan afatgjatë liberalizimin e këtij tregu.



Faza 3

Zbatimi i sistemit BONUS MALUS

Gjithashtu në këtë rregjistrat rol të rëndësishëm në të ardhmen do të luajnë dhe raportet e gjeneruara për sistemin **Bonus-Malus**, me fokusim të veçantë mbi liberalizim të mundshëm të tarifave ose kalim të mirëfilltë në përfaqjen Risk-Based për përllogaritjen e kapitalit minimal të kërkuar për këto portofole në varësi të riskut të marrë në sigurim.



Vështrim mbi tregun e sigurimeve

Janar – Nëntor 2007

Në periudhën Janar – Nëntor 2007, primet e shkruara bruto kapën vleren prej 5,409,260 mijë lekë, perkundrejt 3,968,153 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2006.

Tregu i sigurimeve ka një rritje në masën 36.32 % nga viti i kaluar, ku 93.67 % e kësaj rritje i takon tregut të sigurimeve të Jo-Jetës, ndërsa 6.33 % tregut të sigurimeve të Jetës. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 34.84 % të sigurimeve të Jetës dhe 36.42% të sigurimeve të Jo – Jetës.

Në periudhën Janar – Nëntor 2007, volumi i primeve nga sigurimi i detyrueshëm është rritur në masën 35.90% (nga të cilat vlen të përmendet pesha që ka portofoli MTPL në këtë rritje: 53.70%), ndërsa volumi i primeve të sigurimit vullnetar të Jo-Jetës janë rritur në masën 37.67%.


Në 11 – mujorin e vitit 2007 u lidhën 496,897 kontrata sigurimi perkundrejt 452,108 kontrata të lidhura në të njëjtën periudhë të vitit 2006. Numri i kontratave të sigurimit të Jo-Jetës kap vleren 459,395 nga 431,095 që i takojnë të njëjtës periudhë të një viti më parë. Portofoli MTPL ka shënuar rritjen më të madhe të numrit të kontratave me 32,127 kontrata ose në masën 19.52%.

Vlen të përmendet rritja në masën 78.47% e numrit te kontratave të sigurimit të jetës kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar. Numri i kontratave të sigurimit të Jetës kap vlerën 37,502 nga të cilat sigurimi “Jeta dhe shëndeti në udhëtim” ka një rritje prej 8,184 kontrata , duke shënuar dhe dinamikën më të lartë në rritjen e kontratave të sigurimit të jetës.


Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën Janar - Nëntor (2006 – 2007)

Lloji i sigurimit		Vlera (në mijë Lekë)	
Periudha Nëntor	Janar -	2006	2007
A) Sigurim i Jetës		261,778	352,989
B) Sigurim i Jo - Jetës		3,706,375	5,056,271
<i>nga keto</i>			
a) Sigurimi Detyrueshëm		2,614,180	3,552,688
b) Sigurimi Vullnetar		1,092,195	1,503,583
TOTAL		3,968,153	5,409,260

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto në periudhën Janar – Nëntor 2007



Grafik: Pjesmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit për periudhën Janar – Nëntor 2007 (Jo-Jeta)



Takimi vjetor i IOPS, Forumi Global mbi Pensionet Private OECD/IOPS

Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD) dhe Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve së Pensioneve (IOPS), në bashkëpunim me Komisionin Rregullator të Sigurimeve të Kinës, zhvilluan në Pekin, Kinë gjatë periudhës 13-15 Nëntor 2007, takimet e mëposhtme:

- ❖ Në datë 13 Nëntor 2007 Takimi i Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive të IOPS;
- ❖ Në datë 14 Nëntor 2007 Takimi i Përgjithshëm Vjetor i antarëve të IOPS;
- ❖ Në datë 14-15 Nëntor 2007 OECD/IOPS Forumi Global mbi Pensionet Private.

Në takimet e dy ditëve të para u trajtuan tema të rëndësishme si:

- lidhja midis skemave të pensioneve dhe mbikëqyrjes;
- impakti i krizës së kreditimit mbi skemat e pensioneve;
- eksperiencat në fushën e mbikëqyrjes, rregullimit të pensioneve në Britaninë e Madhe, Austri dhe Hollandë;
- diskutimi i udhëzimeve për supervizionin off-site dhe on-site;
- diskutimi i udhëzimeve për investimet alternative;
- rezultatet e projekteve (projekti mbi skemat DC - rezultate analitike, Itali; rezultatet e projekti të modelimit të cost + fees, eksperiencia Meksikës; projekti i Qeverisjes – Hong Kong; projekti cross-border; projekti i strukturës së Mbikëqyrjes – BM; etj).

Gjithashtu, në këtë takim zuri vend edhe miratimi i raportit vjetor dhe llogarive të 2006, i raportit të auditit, i strukturës së pagesave të 2008, i buxhetit për 2008-2010, i udhëzimit të liçencimit, i programit të punës për 2008-2009.

Mjaft të rëndësishme u konsideruan zgjedhjet e komitetit ekzekutiv dhe zgjedhja e Ross Jones, Nënkryetari i Autoritetit Rregullator të Australisë (APRA), si presidenti i IOPS. Ai zëvendësoi John Ashcroft, nga Enti i Rregullatoreve të Pensioneve të Britanise së Madhe.

Në takimin OECD/IOPS Forumi Global mbi Pensionet Private u trajtuan tema të rëndësishme si:

- zhvillimet në pensionet dhe tregun e sigurimeve në Azi;
- investimet e pensioneve dhe zhvillimi i tregut të kapitaleve;
- impakti i iniciativave në pensionet dhe produktet e sigurimit;
- strukturat e mbikëqyrjes së pensioneve;
- annuities – provigjonet dhe rreziqet.

Duke parë eksperiencën e vendeve pjesëmarrëse, vlen të theksohet se vendi ynë ka një treg të vogël dhe jo shumë të zhvilluar në fushën e pensioneve private. Eksperiencat e vendeve pjesëmarrëse flisin për terma të rendit mbi 80,000 fonde pensionesh private (rasti i Britanisë së Madhe) por edhe të nivelit psh. 7 fonde pensionesh më shumë punëdhënës (multi-employer) dhe 13 fonde pensionesh me një punëdhënës (single-employer) rasti i Austrisë.

Gjatë Takimit Vjetor, u miratuan materialet “Instruksione per Licencimin e Entiteteve të Pensioneve” të përgatitura në bashkëpunim me OECD. Gjithashtu, Komiteti Teknik i IOPS miratoi “Praktika të mira për Mbikëqyrjen e Manaxhimin të Riskut të Investimeve Alternative të Fondeve të Pensioneve”.

Për 2008 dhe 2009, anëtarësia e IOPS vendosi që prioritetet e organizatës të jenë zhvillimi i mëtejshëm i mbikëqyrjes mbi bazë risku, përqëndrimi në drejtimin/qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse dhe zhvillimi i treguesve të monitorimit të performancës në këto institucione. Punë do të bëhet gjithashtu në lidhje me mbikëqyrjen e fortë, si dhe në ndjekjen e punës për provigjonet për antarët e skemave të pensioneve DC (me kontribute të përcaktuara). Konsiderata do t'i jepen çështjeve të annuity të lidhura me mbikëqyrjen e pensioneve dhe do të përgatiten instruksionet për përdorimin e fuqisë së ndërhyrjes. Puna për tabelat e mortalitetit do të koordinohet me IAA³ (Organizata Ndërkombetare e Aktuarëve).

Për informacion

1. Organizata Ndërkombetare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) është themeluar në Paris, 12 Korrik 2004;
2. Qëllimi i IOPS mund të përmbledhet si më poshtë:
 - Të shërbejë si një njësi e vedosjes së standarteve në çështjet e mbikëqyrjes së pensioneve dhe çështje të rregullimit të lidhura me mbikëqyrjen e pensioneve, duke marrë në konsideratë sistemet e ndryshme të pensioneve private;
 - Të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar të mbikëqyrjes së pensioneve dhe të lehtësojë kontaktet midis mbikëqyrësve të pensiove dhe grupeve të tjera të interesuara, duke përfshirë politikëbërësit, kërkuesit dhe sektorin privat;
 - Të realizojë një forum botëror për dialogun mbi politikën dhe shkëmbimin e informacionit për mbikëqyrjen e pensioneve;
 - Të marrë pjesë në punët e institucioneve ndërkombëtare të fushës së pensioneve, përfshirë aktivitetet e përbashkëta për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave dhe analizën;
3. Antarësimi në drejtimin e IOPS është i hapur për të gjitha organizatat përgjegjëse tërësisht ose pjesërisht në mbikëqyrjen e fondeve, planeve, skemave të pensioneve në një vend ose territor të një vendi;
4. Antarësimi i asociuar është i hapur për autoritetet drejtuese dhe ndërkombëtare përgjegjëse për rregullimin e pensioneve ose vendosjen e politikave të pensioneve ose me një interes të drejtpërdrejtë në mbikëqyrjen e pensioneve;
5. Statusi i vëzhguesit është për një rang më të gjerë të njësisive/institucioneve të tjera;
6. IOPS ka aktualisht më shumë se 60 antarë dhe vëzhgues.

³ International Actuary Association

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Baza e të Dhënave të Ligjeve të Sigurimeve (IAIS)

Baza e të Dhënave të Ligjeve të Sigurimeve të IAIS-it ka për qëllim dhe mundëson shkëmbimin e informacionit midis anëtarëve të IAIS-it në mënyrë elektronike. Ajo mbledh të dhëna të plota të ligjeve të sigurimit, rregulloreve dhe praktikave të përdorura nga juridiksione anëtarë të IAIS-it. Të dhënat janë lehtësisht të përdorshme për qëllime të krahasimit të aspekteve ligjore në mbikëqyrjen e sigurimeve dhe ndihmojnë në përmirësimin dhe përshtatjen e sistemeve të ndryshme të mbikëqyrjes. Gjatë vitit 2006, juridiksionet kanë kontribuar me informacionin e tyre në fusha të ndryshme të rregullimit të sektorit të sigurimeve. Në hartimin e raportit për vitin 2006 ka kontribuar edhe AMF si pjesëmarrëse aktive e Nënkomitetit të Bazës së të Dhënave të Ligjeve të Sigurimeve. Informacioni i mëposhtëm jep detaje të juridiksioneve në lidhje me çështje të rregullimit të aftësisë paguese / kapitalit.

Aftësia paguese/Kapitali (kapitulli 11)

IAIS synon të zhvillojë standarde të detajuara dhe udhëzime të pranueshme dhe të zbatueshme lidhur me kërkesat ligjore të vlerësimit të aftësisë paguese të sigurveve. Një regjim i shëndetshëm i aftësisë paguese është thelbësor për autoritetin në mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit dhe mbrojtjen e policëmbajtësve. Kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit janë pjesë e regjimit të aftësisë paguese, i cili duhet të marrë parasysh jo vetëm mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike e matematike në mbulim të shpenzimeve për dëmet e raportuara e të paraportuara, por edhe mjaftueshmërinë e kapitalit për të absorbuar

shpenzime të papritura – të pambuluara nga provigjonet teknike – prej rreziqeve për të cilat kapitali kërkohet të mbahet në mënyrë të veçantë. Në vitin 2006, 24 juridiksione⁴ u janë përgjigjur pyetjeve të kapitullit 11 të Bazës së të Dhënave të Ligjeve të IAIS-it, në lidhje me bazën ligjore të aftësisë paguese. Përgjigjet japin informacion themelor mbi praktikën e juridiksioneve për të garantuar mbrojtjen e policëmbajtësve, ndërkohë që pyetjet shpesh të shtuara rrishtaz në kapitull do të marrin përgjigje me informacionin e vitit 2007 dhe do të japin një pasqyrë më të qartë mbi regjimet e vendeve të ndryshme. Pyetjet shpesh kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme si: format e pranuar të kapitalit, elementët që pëjashtohen nga aftësia paguese, llojet e rreziqeve që duhen marrë parasysh në llogaritjen e marzhit minimal të aftësisë paguese, trajtimi i kostove të ngritjes, përdorimi i modeleve të brëndëshme në matjen e mjaftueshmërisë dhe efektivitetit të kapitalit, kërkesat për biznese që kryhen jashtë territorit të vendit, etj.


Kërkesat dhe kriteret për matjen e aftësisë paguese

Në të gjithë vendet raportuese, shoqëritë duhet të përmbushin kërkesa specifike për aftësinë paguese, në pjesën më të madhe të përshkruara në ligjin e sigurimeve.

⁴ Austria, British Virgin Islands, Canada - Quebec, Chinese Taipei, Croatia, Germany, Guatemala, Hong Kong, Hungary, Isle of Man, Israel, Jersey, Macedonia, Morocco, Pakistan, Poland, Romania, Russia, Singapore, Slovak Republic, Switzerland, Turkey, United Arab Emirates, USA

Aftësia paguese për shoqëritë e sigurimeve llogaritet sipas metodave të përcaktuara që marrin parasysh primet, natyrën e biznesit, aktivet e shoqërisë, përgjegjësitë dhe marrëveshjet e risigurimit si për jetën edhe për jo-jetën. Dëmet e ndodhura dhe ekspozimi i rrezikut marrin rëndësi të veçantë përkatësisht në bizneset e jetës dhe jo-jetës. Një nga juridiksionet raportuese përdor një sistem vlerësimi me bazë rrezikun, çfarë garanton që shoqëria do të ruajë aftësinë paguese deri në fund të vitit.

11.1



Kërkesa për kapital minimal


Të gjitha vendet raportuese u kërkojnë siguruesve të kenë një kapital minimal të caktuar, që duhet të respektohet gjatë gjithë veprimtarisë. Rreth 75% e juridiksioneve zbatojnë të njëjtën kërkesë edhe për degët e shoqërive të huaja.

Çështje të raportimit të aftësisë paguese

Rreth 59% e vendeve raportuese e raportojnë aftësinë paguese një herë në vit, ndërsa vendet e tjera kërkojnë një raportim më të shpeshtë si tre muaj, apo dy herë në vit. Në rrethana të caktuara, mbikëqyrësit e të gjitha vendeve kanë të drejtë të kërkojnë raportime më të shpeshta, apo të menjëhershme të aftësisë paguese.

11.2


Frekuenca e raportimit të aftësisë paguese



Ndërhyrja nga rregullatorët

Në rast se siguruesi nuk plotëson kërkesën e aftësisë paguese, në të gjitha vendet raportuese, mbikëqyrësit mund të marrin masa si: plane për përmirësimin e gjendjes financiare, rritje të kapitalit brenda një kohë të shkurtër, ndalim të përdorimit të lirë të aktiveve, tërheqje të liçencës, transferim të portofolit, etj. Në 88% të vendeve raportuese, mbikëqyrja ka të drejtë të ndërhyjë përpara se kapitali të bjerë nën nivelin e kërkuar ligjor.

11.3



Konferenca “Sfidat kryesore të mbikëqyrjes dhe Bursat në Europën qëndrore, lindore dhe juglindore”

Autoriteti Tregut Financiar Austriak (FMA) dhe Bursa e Vjenës zhvilluan në Vienë, Austri më 29-30 Nëntor 2007 një konferencë mbi “Sfidat kryesore të mbikëqyrjes dhe Bursat në Europën qëndrore, lindore dhe juglindore”.

Gjatë kësaj konference u trajtuan çështje të rëndësishme lidhur me mbikëqyrjen e letrave me vlerë sipas direktivës së instrumentave financiarë dhe drejtimet e përbashkëta të mbikëqyrjes.

Temat kryesore të trajtuara:

- **Konsolidimi i tregut të letrave me vlerë dhe rrjedhimet e tij** - referuar nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të tregjeve dhe shërbimeve në Komisionin Europian;
- **“Corporate Governance”- Status Quo - dhe zhvillimet e ditës** – referuar nga Kryetari i Bursës së Bukureshtit; Kryetari i menaxhimit të aseteve në bankën e Transilvanisë; Këshilltari i Qeverisë Austriake për Tregjet e kapitalit dhe Kryetarja e Bursës së Malit të Zi;
- **Impakti i një regjimi mbikëqyrës të ri në Bursa** – referuar nga Kryetari i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë; Anëtar i Bordit të Bankës Kombëtare të Slovakisë; Drejtori i Departamentit të mbikëqyrjes së letrave me vlerë në Autoritetin e tregut financiar të Austrisë; Zv. kryetare e Drejtorisë së tregut të letrave me vlerë në Komisionin Europian;

- **Sfidat e ditës së politikave ekonomike dhe tregut financiar** – referuar nga Zv.Kancelari Austriak dhe Ministri Federal i Financave.

Këto probleme u prekën nga pjesëmarrës të ndryshëm të cilët sollën eksperiencat e vendeve të tyre duke theksuar që bursat do të kenë rolin e tyre në nxitjen e zhvillimit të një vendi, duke i kushtuar rëndësi të veçantë gjetjes së rrugëve të reja për mbijetesën e bursave të vogla dhe jo mbylljen e tyre. Zbehja e bursave të vogla ka ardhur nga përparësitë që merr sistemi bankar, të cilit globalizmi i ka dhënë përparësi të mëdha. Gjithashtu u theksua nevoja e liberalizimit dhe thjeshtimi i procedurave të pranimit të kompanive në bursa për një bashkëpunim reciprok me bankat, për një kujdes të Qeverisë për bursat sidomos në vëndet në tranzicion.

Parimet e IAIS

1. Parimet Themelore të Sigurimeve të IAIS (Tetor 2000) e përshkruajnë mjaftueshmërinë e kapitalit, midis të tjerave, si një fushë që duhet të gjejë vend në legjislacionet dhe rregulloret e hartuara nga Autoritetet Mbikëqyrëse të Sigurimeve apo institucionet e tjera kompetente në çdo juridiksion.

2. Qëllimi i mbikëqyrjes së siguruesve është mbajtja e një tregu sigurimesh eficient, të sigurt dhe me stabilitet me qëllim përfitimin dhe mbrojtjen e policmbajtësve. Rregullat për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe aftësisë paguese janë një nga elementet më thelbësore në mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit.

3. Një shoqëri sigurimi është solvente, nëse është e aftë të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga të gjitha kontratat nën të gjitha rrethanat e mundshme të parashikueshme.

4. Autoritetet Mbikëqyrëse të Sigurimeve i kërkojnë siguruesve të mbajnë aktive ose kapital shtesë në tejkalim të detyrimeve, që do të thotë “aftësi paguese”.

5. Parimet për Mjaftueshmërinë e Kapitalit dhe Aftësinë Paguese, të përcaktuara në këtë material janë të aplikueshme për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe janë thelbësore për vlerësimin e aftësisë paguese si të shoqërive të sigurimit të jetës ashtu dhe për ato të jo jetës. Shkalla e aplikimit të këtyre parimeve për shoqëritë e risigurimit varet nga shkalla e mbikëqyrjes së industrisë së risigurimit në juridiksionet përkatëse.

6. Aplikimi i këtyre parimeve nga Autoritetet Mbikëqyrëse të Sigurimeve nuk e eliminon nevojën e konsumatorëve për të qenë të kujdesshëm në vlerësimin e risqeve dhe përshtatshmërinë e një produkti sigurimesh për nevojat e tyre. Kompanive të sigurimit duhet t’i kërkojë të publikojnë informacion të saktë për publikun.

7. Për më tepër, parimet nuk e eliminojnë nevojën e siguruesve për të menaxhuar me kujdes risqet e biznesit që ato ndërmarrin. Një sistem mbikëqyrës i shëndoshë duhet të kombinojë mjaftueshmërinë e kapitalit dhe sistemin e aftësisë paguese me kërkesat për sisteme për menaxhimin e riskut me qëllim reduktimin dhe kontrollin e risqeve. Qëllimi i marzhit të aftësisë paguese është të sigurojë një nivel sigurie kundrejt ngjarjeve që mund të ndodhin, të cilat janë jashtë parashikimeve, megjithë masat për parandalimin e këtyre risqeve.

8. Mbikëqyrja e kompanive të sigurimit individualisht nga Autoriteti Mbikëqyrës mbetet baza esenciale e mbikëqyrjes së sigurimeve. Gjithashtu sistemi mbikëqyrës duhet të reflektojë çështje të tjera që lidhen me grupet e kapitalit.

Parimet e Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Aftësisë Paguese të Siguruesve

Parimi 1: Provigjonet teknike

Provigjonet teknike duhet të jenë të sakta, të besueshme, objektive dhe të lejojnë krahasimin ndërmjet siguruesve.

9. Provigjonet teknike të sakta janë një element tepër i rëndësishëm për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe sistemin e aftësisë paguese. Përkatësisht, provigjonet teknike duhet të llogariten në mënyrë të besueshme, objektive dhe konsistente ndërmjet siguruesve të ndryshëm.

10. Metodologjitë dhe praktikat e kontabilitetit të përdorura në përcaktimin e provigjoneve teknike dhe trajtimin e aktiveve, veçanërisht aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, duhet të merren në konsideratë gjatë kërkesave për aftësi paguese që rrjedhin nga provigjonet teknike. Siç theksohet dhe në parimin 6 (ky parim trajton ndjeshmërinë ndaj riskut, më hollësisht do të trajtohet në nr. e ardhshëm) mjaftueshmëria e kapitalit dhe sistemi i aftësisë paguese duhet të marrin në konsideratë vlerësimin e detyrimeve përfshirë dhe provigjonet teknike.

11. Provigjonet teknike duhet të vlerësohen në mënyrë prudente dhe transparente. Provigjonet teknike duhet të jenë të vlerësuara saktë me qëllim mbulimin e detyrimeve ndaj policmbajtësve. Një sigurues duhet të reflektojë eksperiencën e vet dhe të tregut në përcaktimin e provigjoneve teknike. Provigjonet teknike duhet të përfshijnë midis të tjerave, një marzh për dëmet pezull, dëmet e pritshme në të ardhmen, përfitimin e përcaktuar si edhe shpenzimet.

12. Besueshmëria dhe krahasueshmëria e provigjoneve teknike rritet me ndihmën e ekspertëve.

13. Matja objektive e provigjoneve nënkupton një proces objektiv, edhe pse vlerësimi i biznesit të sigurimit përfshin pasiguri në parashikimin e dëmeve.

Parimi 2: Detyrimet e tjera

Provigjonim i saktë duhet bërë për të gjitha detyrimet, për sa kohë ato nuk janë të përfshira në provigjonet teknike

14. Mbikëqyrësit duhet të sigurojnë, që një sigurues të bëjë provigjonim të saktë të të gjitha detyrimeve. Kjo mund të përfshijë detyrimet për palët e treta dhe shumat e përvetësuara, të cilat janë të diskutueshme

Parimi 3: Aktivët

Aktivët duhet të jenë të përshtatshme, të realizueshme dhe të vlerësuara objektivisht.

15. Kompanitë e sigurimit duhet të investojnë duke patur parasysh sigurinë dhe kthimin nga investimet. Aktivët duhet që gjithashtu të jenë të diversifikuara dhe të sigurojnë likuiditet, në mënyrë që të garantojnë përmbushjen e detyrimeve nga kontratat e sigurimit kur ato maturohen.

16. Për shembull, aktivët që mbahen me palët e lidhura në një bazë jo-komerciale si dhe aktivët e patrupëzuara, mund të mos jenë të tregtueshme, mund të kenë një vlerë të ndryshme nga ajo që nevojitet për të shlyer detyrimet me policmbajtësit, ose mund të kenë status të kufizuar kontrolli nga ana e shoqërisë, privilegj të veçantë ose tjetër interesa me palët e treta dhe për këtë qëllim ato janë kryesisht të përjashtuara ose të papërshtatshme për qëllime të llogaritjes së aftësisë paguese.

17. Korniza ligjore rregullatore apo Autoriteti Mbikëqyrës mund të vendosë kërkesa shtesë në lidhje me aktivët, me qëllim vlerësimin e elementëve si më poshtë:

- risku i përqendrimit;
- risku i kreditit;
- risku i tregut;
- risku i likuiditetit;
- risku i likuidimit.

18. Në lidhje me riskun e përqendrimit, rregullat mbikëqyrëse mund të ndalojnë mbajtjen e një aktivi apo një klase të caktuar aktivesh mbi një nivel të caktuar. Në një mënyrë alternative, rregullat mund të mos i kufizojnë këto holdinge. Nëse përqendrimi në holdinge është i lejuar, atëherë në përlllogaritjen e kapitalit apo të aftësisë paguese, duhet lejuar vetëm një sasi e kufizuar e holdingut.

19. Vlerësimi objektiv dhe i vazhdueshëm i aktiveve bazohet në standarde prudente dhe transparente kontabiliteti, të cilat mund të përmirësohen me ndihmën e ekspertëve.

20. Sistemi i vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të konsiderojë bazën e përdorur për vlerësimin e aktiveve. Duhet të inkurajohen praktika dhe standarde prudente kontabiliteti.

Parimi 4: Përputhshmëria

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe sistemet e aftësisë paguese duhet të adresojnë përputhshmërinë e aktiveve me detyrimet.

21. Sistemet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të adresojnë riskun e humbjes si rezultat i mospërputhjeve në:

- valutë;
- përputhjen e afateve në flukset e parasë;
- sasinë e flukseve të parasë të aktiveve dhe detyrimeve të siguruesit të korrektuara në mënyrë që të pasqyrohen dhe ekspozimet jashtë bilancit.

Parimi 5: Amortizimi i humbjeve

Kërkesat për kapital minimal janë të nevojshme për amortizimin e humbjeve që mund të ndodhin nga risqet teknike dhe risqet e tjerë.

22. Kompanitë e sigurimit duhet të jenë të afta të vlerësojnë risqet që ato sigurojnë me qëllim përcaktimin e një niveli të mjaftueshëm primi. Gjithsesi, përcaktimi i tarifave të ulta mund të vijë si pasojë e nënvlerësimit të risqeve, ndryshimit në eksperiencën e dëmeve, apo mangësi në marrjen në sigurim. Si rrjedhojë kompanitë e sigurimit duhet të kenë një nivel të mjaftueshëm kapitali, me qëllim amortizimin e humbjeve të mundshme të paparashikuara.

23. Ky kapital nevojitet gjithashtu për të amortizuar humbjet nga risqet e tjera përfshirë dhe risqet e tjera teknike.

24. Midis risqeve që duhen marrë në konsideratë nga sistemet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese janë:

- të tjerë risqe teknike korrentë (përfshirë riskun e devijimit, riskun e gabimit, riskun e vlerësimit, riskun e risigurimit, riskun e shpenzimeve operative dhe riskun që lidhet me humbjet e mëdha ose katastrofike, apo akumulimin e humbjeve të shkaktuara nga një ngjarje e vetme);
- risqet teknike të veçantë (përfshirë riskun e likuidimit dhe riskun rritjes së tepërt e të pakoordinuar);
- risqet operationale, të tregut, të organizimit dhe konglomeratë;
- risqet e investimit (përfshirë risqet si rrjedhojë e përdorimit të instrumentave financiarë derivate, si dhe risku i zhvlerësimit, likuiditetit, përputhshmërisë, normës së interesit, vlerësimit dhe pjesëmarrjes).

Vijon në numrin e ardhshëm ...